



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 1.10.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

Mbi

Projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 1.10.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Blerina Gjylameti.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji parashikon ndryshimin e nenit 36, të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, duke shtyrë afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave nga

subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” deri më 31 dhjetor 2019.

IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji, propozon një ndryshim në ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ligj i cili ka në fokus nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorë strategjikë, si ai energjetik dhe minerar; transportit, infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe mbetjeve urbane; turizmit; bujqësisë dhe peshkimit, zonave të teknologjisë e zhvillimit ekonomik si dhe zonave me përparësi zhvillimi. Nëpërmjet këtij ligji, janë vendosur procedura të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përsheptuese me qëllim mbështetjen e shërbimeve ndaj investitorëve. Dua të vë theksin në faktin se ishte pikërisht ky ligj, i vitin 2015, i cili bazuar në parimin e transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit, mundësoi përmes një kuadri të plotë ligjor mbrojtje të njëjtë si për investimet e huaja ashtu edhe për investimet vendase, të cilat më parë nuk ishin të mbrojtura.

Ndryshimi i propozuar përmes këtij projektligji, ka për qëllim, zgjatjen e afatit për paraqitjen e kërkesave, nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”. Ky afat është deri më 31 dhjetor 2018 dhe propozohet të zgjatet deri më 31 dhjetor 2019.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shpjeguan se zgjatja e afatit ka për qëllim mundësimin e përfitimit nga lehtësirat që ofron ligji nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” edhe për 1 vit tjetër, për të gjithë investitorët vendas apo të huaj. Projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit. Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Komiteti i Investimeve Strategjike, si dhe të gjitha institucionet dhe organet e administratës shtetërore që kanë në fushën e kompetencave të tyre elementë specifik procedural.

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke vlerësuar se përmes këtij projektligji i jepet një mundësi e shtuar investitorëve vendas dhe të huaj për të investuar në sektorë strategjikë, me votat pro të gjithë të pranishmëve e miratoi projektligjin.

Relator

Kryetar

Blerina GJYLAMETI

Erion BRAÇE